

VENDIM
Nr.340, datë 19.3.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE, PËR KURIMIN E Z. BAJRAM ALIAJ, NË GREQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve, për kurimin e z.Bajram Aliaj në klinikën e përgjithshme të Iasos, në Greqi.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale.
 4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha